FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 41

Tiranë – E martë, 27 mars 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 135, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime".....	2531
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 157, datë 21.3.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	2531
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 21.3.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	2532
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.3.2018	Për pagesën e së ardhurës nga papunësia.....	2532
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 21.3.2018	Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional.....	2534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 163, datë 21.3.2018	Për përcaktimin e procedurës së veçantë të përshpejtuar dhe të kritereve për përzgjedhjen e konsulentit që do të asistojë komisionin për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërive "Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction", me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Aeroportit të Vlorës.....	2535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 21.3.2018	Për negocimin me partnerin privat të përzgjedhur nga shoqëria "Albgaz" sh.a., për krijimin e një shoqërie të përbashkët për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit të ndërtuar nga Trans Adriatic Pipeline AG në territorin e Republikës së Shqipërisë.....	2537

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 21.3.2018	Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë.....	2538
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 26.3.2018	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2018, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Mbrojtjes, për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në zonat e përmbytura në Shkodër.....	2542
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 19.3.2018	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 59, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë; nr. 00-2017-578, datë 22.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	2542
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 15.3.2018	Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat".....	2551
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 17, datë 2.3.2018	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Libohovë.....	2555
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 18, datë 22.3.2018	Për fillimin e procedurës për ndryshimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave.....	2555
	Vendim (*i shkurtuar*) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Zafira Kola.....	2556
	Vendim (*i shkurtuar*) për shpalljen të vdekur të shtetasve Bajram Riza Allamani dhe Esmeralda Bajram Allamani.....	2556

VENDIM
Nr. 152, datë 13.3.2018

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 135, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës "a", të pikës 4, të vendimit nr. 135, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja "a/1", me këtë përmbajtje:

"a/1) të lidhë kontrata të posaçme me prodhues të barnave (*Managed Entry Agreements* ose *MEA*), në kushtet e nenit 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar, në këto raste të veçanta:

i) Kur bari mund të sigurohet vetëm nga një prodhues, i cili zotëron të drejtat ekskluzive mbi atë bar;

ii) Kur përdorimi i teknologjisë së barit mund të rrisë efikasitetin e trajtimit të pacientëve në spitalet publike dhe kur bari është alternativë e vetme për një sëmundje ose indikacion të caktuar;

iii) Për sasi të garantuara bari, me çmim më të ulët se ai i deklaruar, miratuar nga ministria.".

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe spitalet publike në varësi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 157, datë 21.3.2018

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohen individët e renditur në shkronjën "a", të shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

2. Në listën e shkronjës "D", "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohet kompania e renditur në shkronjën "b", të shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË (LISTA E OKB-SË)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida":**

1. SALIM; MUSTAFA, MUHAMMAD, AL-MANSUR;

2. UMAR; MAHMUD, IRHAYYIM, AL-KUBAYSI.

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA

b) Lista e shtuar në **"Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida":**

1. AL-KAWTHAR MONEY EXCHANGE.

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 158, datë 21.3.2018

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 3, "Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin", që i bashkëlidhet vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen fjalët "...Rusi, Arabi Saudite, Bjellorusi, Gjeorgji, Katar, Oman, Tajlandë, Kinë dhe Bahrejn, me dokumentin pasaportë, për periudhën 1 prill deri më 31 tetor 2018.".

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 161, datë 21.3.2018

PËR PAGESËN E SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 54, pikat 1 e 2, dhe 55, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Përfitojnë të ardhura nga papunësia të gjithë personat e siguruar, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 53, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Nuk përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët:

a) ndërpresin aktivitetin si punëdhënës dhe të vetëpunësuar;

b) largohen nga puna me dëshirën e tyre;

c) plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar, paaftësi të përkohshme në punë apo sëmundje profesionale.

4. Personave të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, u paguhet e ardhura e pagesës së papunësisë në varësi të periudhës së kontributit në sigurimet shoqërore, derdhur nga punëdhënësi, si më poshtë vijon:

a) 3 (tre) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 1 (një) vit;

b) 6 (gjashtë) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 3 (tre) vjet;

c) 9 (nëntë) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 5 (pesë) vjet;

ç) 12 (dymbëdhjetë) muaj, për personat me një periudhë kontributi mbi 10 (dhjetë) vjet;

d) Personat gra mbi 55 (pesëdhjetë e pesë) vjeç dhe burra mbi 60 (gjashtëdhjetë) vjeç përfitojnë pagesë papunësie 12 (dymbëdhjetë) muaj, me kusht që të kenë kontribuar 1 (një) vit në sigurimet shoqërore, për çdo rast përfitimi.

5. Për rastet e paraqitjes së kërkesave të përsëritura për përfitim, llogaritja e periudhës së kontributeve fillon me përfitimin e fundit të pagesës të të ardhurave nga papunësia.

6. Personat të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, duhet të paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kërkesë për aplikim;

b) Librezë pune;

c) Dokument identiteti (fotokopje);

ç) Vërtetim për ndjekjen e arsimit të mesëm, për fëmijët në ngarkim deri në moshën 18 vjeç dhe për personat që ndjekin arsimin e lartë apo janë të paaftë (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç.

7. Zyrat e punësimit kanë përgjegjësinë të sigurojnë, për secilin aplikues, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Certifikatë të gjendjes familjare;

b) Vërtetim nga dega e tatim-taksave se personi nuk është subjekt i regjistruar pranë këtyre organeve;

c) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ose e sigurimeve shoqërore se personi ka derdhur kontribute për periudhën e kërkuar, përkatësisht sipas shkronjave "a, "b", "c" dhe "ç", të pikës 4.

8. Personave përfitues të pagesës të së ardhurës nga papunësia u ndërpritet përfitimi kur:

a) refuzojnë të punësohen ose të ndjekin një program punësimi të përshtatshëm, të ofruar nga zyra e punësimit;

b) refuzojnë të marrin pjesë në kurse trajnimi dhe kualifikimi, të ofruara nga zyra e punësimit;

c) nuk paraqiten një herë në muaj;

ç) plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar.

9. Personat duhet të njoftojnë brenda 5 (pesë) ditëve zyrën përkatëse të punësimit nëse gjatë periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia:

a) punësohen ose vetëpunësohen;

b) kanë ndryshime në gjendjen familjare (lindje apo vdekje);

c) personat që ka në ngarkim të tij kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe ata që studiojnë apo janë të paaftë (KMCAP) kanë mbushur moshën 25 vjeç.

Në të kundërt, ata duhet të kthejnë shumën e të ardhurave që kanë përfituar gjatë kësaj periudhe në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore.

10. Masa e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia për çdo përfitues është 50% e pagës minimale në shkallë vendi.

11. Personat, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e së ardhurës nga papunësia, kanë të drejtë të marrin të ardhura shtesë familjare mbi masën e nivelit bazë, në masën 5% të të ardhurave nga papunësia, për çdo fëmijë në ngarkim, deri në moshën 18 vjeç, si dhe për personat që janë duke vazhduar studimet ose janë të paaftë (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç. Shtesa familjare për çdo fëmijë, në masën 5% të nivelit bazë, nuk duhet të jetë më shumë se 30%.

12. Fëmijët mbi moshën 15 vjeç (mosha minimale sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë), të cilët janë në ngarkim të personit përfitues të së ardhurës nga papunësia dhe që nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor, nuk do të përfitojnë shtesën familjare prej 5%.

13. Kur prindërit janë të divorcuar me vendim gjykate, shtesën familjare e merr prindi që ka fëmijën në ngarkim.

14. Në rastet e punësimit të përkohshëm gjatë periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, e ardhura e papunësisë merret me ndërprerje, si më poshtë vijon:

a) Brenda 6 (gjashtë) muajve, për personat që e përfitojnë pagesën për 3 (tre) muaj;

b) Brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve, për personat që e përfitojnë pagesën për 6 (gjashtë) muaj;

c) Brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve, për personat që e përfitojnë pagesën për 9 (nëntë) muaj;

ç) Brenda 24 (njëzet e katër) muajve, për personat që e përfitojnë pagesën për 12 (dymbëdhjetë) muaj.

15. Përfituesi i pagesës të së ardhurës nga papunësia është i detyruar të paraqitet në zyrën e punësimit një herë në muaj për të konfirmuar prezencën e tij ose sa herë thirret nga kjo zyrë, me qëllim punësimin e tij.

16. Rastet e përligjura, kur përfituesi është i justifikuar për mosparaqitje, janë:

a) sëmundje, e vërtetuar me dokumente (fletë-shtrimi në spital);

b) vdekja e një pjesëtari të familjes, e vërtetuar me certifikatë vdekjeje;

c) ndalimi nga organet e drejtësisë.

17. Për të gjitha rastet e përmendura në pikën 16, pagesa e së ardhurës nga papunësia nuk do të regjistrohet në listëpagesën e muajit. Kjo e ardhur do të paguhet në momentin që personi paraqitet në zyrën e punësimit me një nga dokumentet justifikuese. Në rast të kundërt, kjo pagesë do të derdhet në buxhetin e shtetit dhe është e pakthyeshme.

18. Pagesa e së ardhurës nga papunësia është mujore dhe paguhet përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë ta marrë këtë të ardhur. Pagesa merret një herë në muaj, pranë bankës përkatëse.

19. Periudha, gjatë së cilës përfituesi merr pagesën e së ardhurës nga papunësia, njihet si vjetërsi pune, e siguruar për efekt pensioni pleqërie, familjar dhe invaliditeti.

20. Në rast se gjatë kohës së përfitimit të së ardhurës nga papunësia përfituesi largohet me banim (leje banimi) në një vend tjetër, zyra e punësimit dërgon zyrtarisht dosjen me dokumentacionin përkatës në zyrën e punësimit të rrethit ku ai është transferuar.

21. Punëkërkuesi i papunë, i cili qendrën e fundit të punës e ka në juridiksionin e një zyre tjetër punësimi nga vendbanimi aktual, pasi të ketë konfirmuar formularin e dyfishtë në organet e sigurimeve shoqërore, ku ka qenë qendra e fundit e punës së tij, fillon procedurën e aplikimit. Caktimi i përfitimit bëhet në zyrën e punësimit ku ka vendbanimin aktual.

22. Financimi i programit të pagesës të së ardhurës nga papunësia mbulohet nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, në zërin 606, "Pagesa e së ardhurës nga papunësia", miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

23. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006, "Për pagesën e së ardhurës nga papunësia", i ndryshuar, dhe nr. 192, datë 9.3.2016, "Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia", shfuqizohen.

24. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit për nxjerrjen e udhëzimit "Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, "Për pagesën e së ardhurës nga papunësia"" dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 162, datë 21.3.2018

PËR PAGESËN E PJESËMARRJES NË KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punëkërkuesit e papunë, të cilëve u është ofruar dhe kanë pranuar të marrin pjesë në një kurs të formimit profesional (kurse profesionesh), mund të përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 50% të së ardhurës nga papunësia, me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë.

2. Pagesa jepet për ndjekjen vetëm të një kursi, gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

3. Punëkërkuesit e papunë, sipas pikës 1, përfitojnë një herë të vetme nga ky program.

4. Në zyrën e punësimit ngrihet komisioni i vlerësimit, i përbërë nga, të paktën, tre persona, i cili vlerëson rast pas rasti punëkërkuesit të cilët do të marrin këtë pagesë, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren përkatëse, të përcaktuar në pikën 11, të këtij vendimi.

5. Pagesa kryhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas dërgimit të një konfirmimi nga institucioni ofrues i kursit që pjesëmarrja në programin e formimit profesional është e rregullt.

6. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informojnë çdo muaj drejtoritë rajonale

të shërbimit social shtetëror për personat që kanë përfituar nga programet e formimit profesional, shoqëruar me listën emërore dhe programin nga i cili kanë përfituar.

7. Në rastet kur vendbanimi i punëkërkuesit të papunë është mbi 2 km larg institucionit ofrues të kursit të formimit profesional, zyra e punësimit paguan një kosto mujore transporti, në masën e përcaktuar në kuadrin ligjor për tarifat e transportit të udhëtarëve.

8. Financimi i këtij programi mbulohet nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, zëri "Nxitja e punësimit", miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

9. Shërbimi Kombëtar i Punësimit monitoron ecurinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet strukturës së ndihmës shtetërore në ministrinë përgjegjëse.

10. Programi të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2018 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 5 (pesë) vjet.

11. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit për mbikëqyrjen e zbatimit të programit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për nxjerrjen e rregullores së komisionit të vlerësimit dhe të kritereve të miratimit të pagesës në zbatim të programit, nëpërmjet strukturave në varësi të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 163, datë 21.3.2018

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË TË PËRSHPEJTUAR DHE TË KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E KONSULENTIT QË DO TË ASISTOJË KOMISIONIN PËR NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS, NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE SHOQËRIVE "ÇENGIZ CONSTRUCTION & KALYON & KOLIN CONSTRUCTION", ME OBJEKT PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E AEROPORTIT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të ligjit nr. 4/2018, "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërive "Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction", me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Aeroportit të Vlorës", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ngarkohet me cilësinë e autoritetit kontraktor që të krijojë komisionin për ndjekjen e procedurave për përzgjedhjen me procedurë të veçantë të konsulentit për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërive "Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction", me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Aeroportit të Vlorës".

2. Komisioni të përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, specialistë të fushave përkatëse të autoritetit kontraktor (juristë, ekonomistë dhe inxhinierë).

3. Komisioni do të kryejë identifikimin e shoqërive konsulente që ofrojnë shërbim në fushën e këshillimit juridiko-financiar e teknik, bazuar edhe në eksperiencat e mëparshme të bashkëpunimit të shtetit shqiptar me këto shoqëri, si dhe në vlerësimet e këtyre konsulentëve në publikime kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Ftesa për ofertë duhet të përmbajë specifikimin e objektit dhe të llojit të shërbimit të kërkuar, nevojën e kontraktimit të konsulentëve, kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga konsulentët dhe datën përfundimtare të pranimit të kërkesës nga të interesuarit dhe:

a) në çdo rast, numri i shoqërive të identifikuara nuk duhet të jetë më i vogël se tre;

b) komisioni fton të gjitha shoqëritë që të paraqesin dokumentacionin për të provuar kapacitetin e tyre për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, brenda një periudhe jo më shumë se 7 ditë nga data e dërgimit të ftesës. Ftesa dhe kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbajnë elementet që përcaktohen në këtë vendim;

c) komisioni vlerëson kompanitë që përmbushin kriteret dhe i fton ato për paraqitjen e ofertës teknike dhe financiare;

ç) në përfundim të vlerësimit, komisioni harton një raport përmbledhës për zhvillimin e procedurës dhe ia paraqet për miratim titullarit të autoritetit kontraktor;

d) komisioni vazhdon vlerësimin edhe në rast të paraqitjes së një oferte/operatori ekonomik të vetëm, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për ofertë;

dh) në rast kualifikimi të një ose më shumë ofertave, komisioni i lë kohën e nevojshme, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë pune, ofertuesit/ofertuesve për paraqitjen e ofertës tekniko-financiare.

e) pas paraqitjes së ofertave/ofertës, komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune, bën vlerësimin përfundimtar dhe harton raportin përfundimtar sipas përcaktimit në shkronjën "ç", të këtij neni.

5. Kriteret ligjore, teknike dhe financiare që duhet të plotësojnë ofertuesit/operatorët ekonomikë për pjesëmarrje dhe kualifikim janë, si më poshtë:

a) Të kenë dokumentacionin e regjistrimit në QKB ose një dokument ekuivalent për operatorët e huaj;

b) Të kenë një vetëdeklarim që operatori nuk është në proces falimentimi dhe në ndjekje penale;

c) Të kenë, të paktën, një kontratë për shërbim të ngjashëm, të realizuar brenda tri viteve të fundit. Shërbimi duhet të jetë ofruar dhe realizuar për një investim me vlerë minimale 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) euro;

ç) Të kenë një xhiro vjetore mesatare të tri viteve të fundit jo më pak se 50% të vlerës së investimit;

d) Të kenë një përshkrim të detajuar i metodologjisë që do të përdoret për realizimin e shërbimit të kërkuar të shoqëruar me një grafik të hapave që do të ndërmerren dhe afatet përkatëse.

6. Ofertat e kualifikuara do të vlerësohen në bazë të çmimit të ofruar. Oferta me çmimin më të ulët do të jetë oferta fituese. Fondi limit është 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, pa përfshirë TVSH-në.

7. Operatorët duhet të paraqesin ofertat e tyre, në zarfe të mbyllura, të firmosura dhe të vulosura me shënimin:

- "Për procedurën e veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Aeroportit të Vlorës".
- Të mos hapen para datës dhe orës së përcaktuar në ftesën për ofertë.
- Autoritetin kontraktues dhe adresën.
- Emrin e ofertuesit dhe adresën e tij, kontaktin telefonik, *e-mail*.

Në ofertën e tyre konsulentët mund të deklarojnë që do të bashkëpunojnë me firma lokale për çështje të ndryshme teknike.

8. Ofertat hapen nga komisioni në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për ofertë. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nëse është në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe ftesës për ofertë.

Komisioni, brenda 3 (tri) ditëve pune, njofton dhe fton ofertuesit e kualifikuar për paraqitjen e ofertës teknike dhe financiare, ndërsa ofertuesit e pasuksesshëm për arsyet e skualifikimit.

9. Ofertuesi i skualifikuar ka të drejtën e ankimimit pranë titullarit të autoritetit kontraktor. Titullari i autoritetit kontraktor cakton një person për shqyrtimin e ankesës dhe i kthen përgjigje brenda 2 (dy) ditëve.

Në rast se ankesa merret në konsideratë, operatorit i lihen në dispozicion 10 (dhjetë) ditë për përgatitjen e ofertës tekniko-financiare. Ky vendim i bëhet i ditur edhe operatorëve të tjerë të kualifikuar duke përcaktuar afatin e ri.

Ankimimi nuk e pezullon procedurën e garës.

10. Pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i autoritetit kontraktor, komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve, fton operatorin fitues të negociojë

kushtet e kontratës. Çmimi si kriter i vlerësimit është kusht i panegociueshëm. Palët duhet të përfundojnë negocimin brenda 7 (shtatë) ditëve. Nëse dështojnë negociatat me operatorin fitues ose nëse ai tërhiqet, komisioni fton për negocim operatorin e radhës, nëse ka. Në rast se nuk mbetet asnjë ofertues në garë, autoriteti kontraktor do të rihapë garën.

11. Në rast të një procedure të suksesshme për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës me shoqëritë "Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction", komisioni i negocimit të kontratës do të vendosë si kusht në kontratën e konsulencës edhe detyrimin e këtyre shoqërive për të paguar vlerën përkatëse të paguar nga autoriteti kontraktor për konsulencën e dhënë nga operatori ekonomik fitues.

12. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 164, datë 21.3.2018

PËR NEGOCIMIN ME PARTNERIN PRIVAT TË PËRZGJEDHUR NGA SHOQËRIA "ALBGAZ" SHA, PËR KRIJIMIN E NJË SHOQËRIE TË PËRBASHKËT PËR MIRËMBAJTJEN E RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË NDËRTUAR NGA *TRANS ADRIATIC PIPELINE AG* NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 95 dhe 100, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr. 233, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe marrëveshjes për përfitimet vendëse, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë ecurinë e negocimit me partneritetin privat të përzgjedhur nga shoqëria "Albgaz" sh.a., për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit të ndërtuar nga *Trans Adriatic Pipeline AG* në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të një shoqërie të përbashkët me këtë partner privat.

2. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) Shoqëria "Albgaz" sh.a. është shoqëri me kapital 100 % shtetëror, që vepron si operator i kombinuar i gazit natyror duke kryer veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

b) "Institucion përgjegjës" është shoqëria "Albgaz" sh.a.

c) "Partner privat" është ofertuesi i shpallur fitues i procedurës konkurruese për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit të ndërtuar nga dhe nën pronësinë e *Trans Adriatic Pipeline AG* në territorin e Republikës së Shqipërisë, Operatori Italian i Transmetimit të Gazit Natyror, SNAM s.p.a., me të cilin shoqëria "Albgaz" sh.a. do të krijojë një shoqëri të përbashkët të inkorporuar në formën ligjore, sipas parashikimeve të ligjit për shoqëritë tregtare.

3. Komisioni i negocimit të marrëveshjes me partnerin privat të përzgjedhur, me të cilin do të krijohet shoqëria e përbashkët e inkorporuar, ngrihet me urdhër të ministrit që përfaqëson Asamblenë e Aksionarit të Vetëm dhe përbëhet nga shtatë anëtarë. Anëtarë të këtij grupi janë dy përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dy përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, një përfaqësues nga Avokatura e Shtetit, si dhe dy përfaqësues nga shoqëria "Albgaz" sh.a. Kryetar i grupit është administratori i shoqërisë "Albgaz" sh.a.

4. Brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, titullarët e institucioneve dërgojnë emrat e anëtarëve përfaqësues në këtë komision në shoqërinë "Albgaz" sh.a.

5. Nuk mund të marrin pjesë në komisionin e negocimit personat që kanë konflikt interesi me ofertuesit, sipas kuptimit të ligjit "Për konfliktin e interesit".

6. Procedurat e negocimit përfundojnë jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

7. Kontrata përmban kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi, kushtet kryesore të negocimit me shoqërinë TAP AG, termat e referencës së procedurës së përzgjedhjes, si dhe parashikon ata terma që vlerësohen të përshtatshëm nga palët për realizimin e qëllimit të bashkëpunimit, duke përfshirë raportin e aksioneve dhe kushtet kryesore të ushtrimit të aktivitetit.

8. Shoqëria "Albgaz" sh.a., pas negocimit të kontratës së partnertitetit kërkon miratimin e shoqërisë *Trans Adriatic Pipeline AG*.

9. Pas marrjes se miratimit nga shoqëria *Trans Adriatic Pipeline AG*, shoqëria "Albgaz" sh.a. paraqet për miratim te organet e shoqërisë, përkatësisht Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarit të Vetëm, raport të detajuar për negociatat për të gjitha elementet e marrëveshjes me ofertuesin e përzgjedhur, përfshirë projektin përfundimtar të marrëveshjes për krijimin e shoqërisë të përbashkët të inkorporuar në formën ligjore të shoqërisë aksionare.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Avokatura e Shtetit dhe shoqëria "Albgaz" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 165, datë 21.3.2018

PËR METODOLOGJINË E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE TË NJËSIVE BAZË TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e metodologjisë së procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, mbështetur në kriteret e vlerësimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kriteret vlerësimit të njësive bazë përfshijnë një listë treguesish që përllogariten sipas kontributit katërvjeçar të njësisë bazë në fushën e kërkimit shkencor, vlerësim i cili realizohet sipas një sistemi pikëzimi, të miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, për efekt të procesit të vlerësimit, grupohen sipas fushave e nënfushave kryesore natyrore, inxhinierike e teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale e humane, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, llojeve të IAL-ve, formës së organizimit, publike apo jopublike, si dhe sipas veprimtarisë kryesore të departamenteve, qendrave kërkimore-shkencore apo qendrave studimore ndërdisiplinore.

4. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë realizohet çdo katër vjet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) Kriteri bibliometrik:

i) Lista e artikujve të botuar në revista ndërkombëtare shkencore me faktor impakti, si dhe në revista akademike ndërkombëtare të indeksuara dhe të recensionuara;

ii) Lista e artikujve të botuar brenda vendit në revista shkencore dhe buletine shkencore të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

iii) Lista e monografive shkencore të botuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;

iv) Lista e monografive shkencore të botuara brenda vendit, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;

v) Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës dhe të vlerësuar si punime shkencore nga njësia bazë;

vi) Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar brenda vendit, si dhe të vlerësuar si punime shkencore nga njësia bazë.

b) Kriteri i impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore:

i) Lista e patentave apo e shpikjeve të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale apo autoriteteve të huaja;

ii) Lista e projekteve kërkimore-shkencore të fituara nga programet kuadër të BE-së për kërkim shkencor, si koordinator projekti ose si partner në projekt;

iii) Lista e sipërmarrjeve të reja, të krijuara si rezultat i punës kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë;

iv) Lista e kontratave të shërbimit me objekt studimor.

c) Kriteri infrastrukturor:

i) Lista e laboratorëve shkencorë të akreditуar ose jo;

ii) Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;

iii) Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;

iv) Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshirë dhe ato elektronike.

ç) Kriteri i kapaciteteve njerëzore:

i) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, me tituj akademikë: "profesor", "profesor i asociuar", "lektor" dhe "asistent lektor" , me kohë të plotë, në momentin e deklarimit;

ii) Lista e konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga njësia bazë në bashkëpunim me homologët e saj, në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

iii) Lista e konferencave shkencore kombëtare të organizuara nga njësia bazë;

iv) Lista e pjesëmarrjes së personelit akademik të njësisë bazë, me referime shkencore, në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

v) Lista e pjesëmarrjes me referime shkencore të personelit akademik të njësisë bazë në konferenca shkencore kombëtare;

vi) Lista e çmimeve ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

vii) Lista e çmimeve kombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë;

viii) Lista e programeve të "master ekzekutiv", "specializime afatgjata në mjekësi" dhe "doktoratë";

ix) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore periodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

x) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

xi) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore vendëse, të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

xii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike vendëse;

xiii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë të komiteteve shkencore të konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

xiv) Lista e recensuesve nga personeli akademik i njësisë bazë për artikuj shkencorë të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës.

d) Kriteri i ndërkombëtarizimit:

i) Lista e studimeve dhe e kërkimeve lëndore ose ndërdisiplinore të aplikuara me partner të vendeve të OECD-së dhe BE-së/të tjerë;

ii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e matur person/në javë;

iii) Lista e personelit të huaj akademik të njësisë bazë nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë, e matur person/në javë;

iv) Lista e programeve të studimit për "master i shkencave" dhe të ciklit të tretë, të përbashkëta me IAL-të e huaja nga vendet e OECD-së dhe të BE-së, që përfundojnë me lëshimin e një diplome të përbashkët ose të dyfishtë.

5. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësie bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi i Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor - ACRIS.

6. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizon, administron, monitoron dhe publikon rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

7. Institucioni i arsimit të lartë, pas marrjes së njoftimit nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, njofton dhe vendos afate për personelin akademik të njësive bazë, që të realizojnë procesin përkatës të plotësimit të të dhënave të kërkuara, në portalin "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore", në platformën ACRIS.

8. Drejtuesi i njësisë bazë udhëzon, monitoron dhe ndjek të gjitha vetëdeklarimet e të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, duke kërkuar nga të gjithë anëtarët e njësisë përgjegjshmëri në plotësimin e informacionit, sipas kritereve të përcaktuara, në portalin "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore".

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit janë si më poshtë:

a) Të organizojë dhe të administrojë procesin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në Shqipëri";

b) Të njoftojë institucionet e arsimit të lartë, nëpërmjet manualeve elektronike dhe të shkruara, për mënyrën e regjistrimit të të dhënave nga njësitë bazë në sistem, për afatet e plotësimit të formularëve të vlerësimit *online* e të tjera;

c) Të publikojë raportin përfundimtar të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë dhe renditjen e tyre, në formë elektronike dhe të printuar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë dhe të drejtuesve të njësive kryesore në institucionet e arsimit të lartë gjatë procesit të vlerësimit janë si më poshtë:

a) Të caktojë një person kontakti brenda njësisë bazë që ndjek procesin e realizimit në afat të vlerësimit;

b) Të koordinojë, të monitorojë dhe të ndjekë procesin e hedhjes së të dhënave nga personeli akademik i njësive bazë të IAL-ve, brenda afatit të përcaktuar.

III. ORGANIZIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT

1. Anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë do të kenë akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur, për vetëdeklarimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të drejtimeve kryesore të fushave të kërkimit dhe të disiplinave specifike.

2. Drejtuesi i njësisë bazë ka akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur që shërben për ndjekjen dhe monitorimin e të dhënave të deklaruara nga anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë.

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për administrimin e portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore", sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të publikuara, zbatimin standardeve të përgjithshme të vlerësimit dhe certifikimin e rezultateve të vlerësimit.

IV. PLAFTFORMA *ON-LINE* ACRIS – ALBANIA CURRENT RESEARCH INFORMATION SISTEM–PLATFORMA *ON-LINE* E SISTEMIT SHQIPTAR TË INFORMACIONIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë krijohet platforma e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS, e cila shërben si bazë kombëtare të dhënash për kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të nenit 13, të ligjit nr. 87/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të realizuara mbi bazën e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

2. Në bazë të të dhënave të hedhura në sistemin ACRIS nga njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, vlerësimi gjenerohet me pikë, automatikisht nëpërmjet algoritmit kompjuterik të sistemit të pikëzimit, për çdo kriter e indikator të përcaktuar në këtë vendim.

3. Në bazë të këtij sistemi vlerësimi, njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë renditen brenda së njëjtës fushë kërkimi dhe në bazë të IAL-ve, si dhe hartohet raporti përfundimtar që i përcillet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, që i nënshtrohen procesit të vlerësimit, brenda dhjetorit 2019, plotësojnë dhe vetëdeklarojnë në platformën ACRIS veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore, sipas treguesve të kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë fillon jo më vonë se muaji tetor 2019.

3. Urdhri i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për sistemin e pikëzimit të treguesve, që përbëjnë kriteret e metodologjisë së vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë miratohet brenda muajit maj 2018.

4. Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë për institucionet e arsimit të lartë me drejtim ushtarak, policor, artistik dhe sportiv, përcaktohen me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Rrjeti Akademik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
KLASIFIKIMI I FUSHAVE DHE I NËNFUSHAVE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Nr.	Fushat kryesore	Nënfusha
1	**Shkenca të natyrës**	Matematikë dhe Informatikë
		Fizikë
		Kimi
		Shkenca të tokës
		Biologji
2	**Shkenca inxhinierike dhe teknologjike**	Inxhinieria mekanike, elektrike ekonomike, materiale, fizike, navale, tekstil
		Inxhinieri e teknologjisë së informacionit, Inxhinieri matematike
		Inxhinieri e ndërtimit, mjedisit, Arkitektura
		Inxhinieri e gjeologjisë, minierave
3	**Mjekësia**	Mjekësi, Farmaci, Stomatologji, Shkenca teknike mjekësore
4	**Shkenca sociale dhe humanitare**	Shkenca politike dhe sociale
		Histori, Filozofi, Pedagogji, Psikologji
		Shkenca juridike
		Shkenca të antikitetit, filologjisë, letërsisë
		Ekonomi dhe Statistikë
5	**Shkenca bujqësore**	Bujqësi
		Veterinari

VENDIM
Nr. 166, datë 26.3.2018

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2018, NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE MINISTRISË SË MBROJTJES, PËR SIGURIMIN E BAZËS USHQIMORE PËR BLEGTORINË NË ZONAT E PËRMBYTURA NË SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2018 bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në programin buxhetor 04250, "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun", artikulli 606, "Transfertë në buxhetet familjare", zëri "Shpenzime korente", i pakësohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor 02150, "Mbështetja e luftimit", i shtohet fondi i përmendur në shkronjën "a", të kësaj pike, për t'u përdorur për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në zonat e përmbytura në Shkodër.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 8, datë 19.3.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare	e "	"
Fatmir Hoxha,	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.12.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 65/8 Akti, që u përket:

KËRKUES: Dritan (Gramoz) Rexhepi[1]

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 59, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë; nr. 00-2017-578, datë 22.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 32, 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Pas përfundimit të hetimeve paraprake, prokuroria ka dërguar për gjykim çështjen penale

[1] Sipas vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, mbiemri i kërkuesit rezulton "Rexhepaj", kurse sipas kërkesës dhe akteve bashkëlidhur saj rezulton "Rexhepi".

në ngarkim të shtetasve SH.S. dhe S.H. dhe kërkuesit Dritan (Gramoz) Rexhepi për kryerjen e veprave penale "Vrasje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës", në bashkëpunim, në dëm të shtetasit A.K.; "Vrasje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës", në bashkëpunim, në dëm të shtetasit D.K.; "Vrasje me dashje", në bashkëpunim, në dëm të shtetasit R.B.; "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake", të parashikuara nga nenet 79/c-25, 79/c-25, 76-25 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata, në kushtet kur kërkuesi ka qenë në mungesë, ka bërë ndarjen e procedimit penal. Për sa u takon të pandehurve SH.S. dhe S.H. rezulton se me vendimin e formës së prerë nr. 33, datë 31.5.2011, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë është vendosur pushimi i gjykimit, pasi nuk u vërtetua fajësia e tyre.

3. Në lidhje me çështjen penale në ngarkim të kërkuesit rezulton se me vendimin nr. 51, datë 6.6.2013, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë ka vendosur: *"Deklarimin fajtor të të pandehurit Dritan (Gramoz) Rexhepaj për kryerjen e veprës penale të "Vrasjes me paramendim", në bashkëpunim, në dëm të shtetasit D.K., të parashikuar nga nenet 78 e 25 të KP-së, para ndryshimeve të vitit 2001, dhe dënimin e tij në bazë të këtyre dispozitave me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dritan (Gramoz) Rexhepaj për kryerjen e veprës penale të "Plagosjes së rëndë, me pasojë vdekjen", në bashkëpunim, në dëm të shtetasit R.B., të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 88 e 25 të KP-së, dhe dënimin e tij në bazë të këtyre dispozitave me 15 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dritan (Gramoz) Rexhepaj për kryerjen e veprës penale të "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit", të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013, dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 5 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, dënimin përfundimtar të të pandehurit Dritan (Gramoz) Rexhepaj me 25 vjet burgim.".*

4. Me vendimin nr. 69, datë 7.10.2013, mbi bazën e ankimit të prokurorit dhe mbrojtësit, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 6.6.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, si dhe mbrojtësi i kërkuesit.

5. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, mbi kërkesën e mbrojtësit, është kërkuar rivendosja në afat e së drejtës së ankimit për vendimin nr. 51, datë 6.6.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Kjo e fundit, me vendimin nr. 1, datë 9.1.2014, ka vendosur pranimin e kësaj kërkese.

6. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, pasi ka ardhur në dijeni të faktit që çështja penale në ngarkim të kërkuesit Dritan (Gramoz) Rexhepi ishte duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit të saj.

7. Me vendimin nr. 00-2015-653, datë 2.4.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga prokurori dhe mbrojtësi i të gjykuarit.

8. Në kushtet kur shkaku i pezullimit ka rënë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur të revokojë vendimin e pezullimit dhe, duke vlerësuar se ankimi i ushtruar nga prokurori është marrë në diskutim nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2015-653, datë 2.4.2015, të gjykojë çështjen vetëm për shkaqet e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i kërkuesit. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 59, datë 18.5.2015, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 6.6.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë."* Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Me vendimin nr. 00-2017-578, datë 22.6.2017, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

10. ***Kërkuesi Dritan (Gramoz) Rexhepi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të kërkesës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

10.1. Për ngjarjet e ndodhura prokuroria, pasi ka përfunduar hetimin ka dërguar në Gjykatë çështjen për tre të pandehur. Pas ndarjes së procedimit për kërkuesin nuk ka pasur ndonjë veprim hetimor të mëvonshëm ku të jetë siguruar ndonjë provë e re. Duke u dhënë vlerësim tjetër provave të administruara gjykatat kanë cenuar parimin e barazisë para ligjit.

10.2. Gjykatat që gjykuan çështjen në ngarkim të kërkuesit nuk morën parasysh vendimin e formës së prerë që ka vendosur pushimin e gjykimit, për dy të pandehurit e tjerë të deklaruar të pafajshëm, duke cenuar edhe parimin e gjësë së gjykuar. Gjithashtu, është shkelur edhe parimi i mbledhjes së provave në mënyrë të ligjshme, pasi në një vendim me të njëjtin objekt shumë nga provat kanë rezultuar të papërdorshme.

10.3. Gjykata e Apelit ka shkelur rregullat e njoftimit dhe të thirrjes së të pandehurit në gjykim. Nga ana e mbrojtjes është njoftuar se kërkuesi ndodhej i arrestuar në një shtet tjetër, ndaj ajo duhej të zbatonte dispozitat procedurale për njoftimin e të pandehurit që ndodhet jashtë shtetit. Në këtë mënyrë është shkelur e drejta e mbrojtjes dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim.

10.4. Kolegji Penal nuk e pranoi rekursin edhe pse këto shkelje janë evidente. Ai ishte i detyruar t'u jepte përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, duke arsyetuar vendimin e tij.

10.5. Gjykata e Lartë ka shkelur parimin e paanshmërisë në gjykim, pasi të njëjtët gjyqtarë të Kolegjit Penal kanë marrë pjesë në trupën gjykuese që ka shqyrtuar më parë rekurset kundër vendimeve penale të dhëna për kërkuesin.

11. ***Subjekti i interesuar***, Prokuroria e Përgjithshme, në prapësimet me shkrim ka argumentuar sa vijon:

11.1. Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë para ligjit është i pabazuar. Në vendimet gjyqësore që lidhen me çështjen e kërkuesit pranohet, analizohet dhe vlerësohet fakti se shtetasve S.H. dhe SH.S. u është dhënë pafajësia, ndërkohë në vijim analizohen e vlerësohen provat në lidhje me përgjegjësinë penale të kërkuesit, duke arritur në konkluzionin se ai është fajtor.

11.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është i pabazuar. Kërkuesi nuk sqaron se cilit proces i referohet. Pasi ai është vënë në dispozicion të organeve të drejtësisë, ka autorizuar mbrojtësin për ta përfaqësuar në proces me anë të prokurës së posaçme. Ky mbrojtës në rekurs nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me gjykimin në mungesë.

11.3. Në lidhje me pretendimin se i është mohuar e drejta e aksesit në Gjykatë, për shkak të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, rezulton se Kolegji Penal ka bërë vlerësim për ekzistencën e shkaqeve të rekursit, duke arritur në përfundimin se nuk plotësohen kërkesat e nenit 432 të KPP-së. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim është i pabazuar.

11.4. Në lidhje me papajtueshmërinë e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në gjykim, rezulton se anëtarët e Gjykatës së Lartë E.I., SH.S. dhe A.Z., që kanë dhënë vendimet nr. 653, datë 2.4.2015 dhe nr. 578, datë 22.6.2017, në ngarkim të kërkuesit, kanë marrë pjesë edhe në Kolegjin Penal që ka dhënë vendimin nr. 1543, datë 6.12.2012 që lidhet me gjykimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasve S.H. dhe SH.S. Këto vendime ata i kanë dhënë brenda kompetencave që u njeh ligji dhe nuk rezulton që të kenë marrë pjesë në gjykimet e zhvilluara ndaj kërkuesit në shkallët e tjera të gjyqësorit. Po ashtu, vendimet e dhëna nga Kolegji Penal në lidhje me kërkuesin trajtojnë çështje të ndryshme, pasi vendimi i vitit 2015 trajton pretendimet e ngritura nga prokurori, kurse vendimi i vitit 2017 trajton pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi

(shih vendimin nr. 28, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit nuk ka respektuar rregullat e njoftimit dhe thirrjes së të pandehurit në gjykim. Nga ana e mbrojtjes është njoftuar se kërkuesi ndodhej i arrestuar në një shtet tjetër, ndaj ajo duhej të zbatonte dispozitat procedurale për njoftimin e të pandehurit që ndodhet jashtë shtetit. Kjo Gjykatë, ndonëse është njoftuar për mospjesëmarrjen në gjykim për shkaqe të përligjura të avokatit të zgjedhur, ka vijuar gjykimin në mungesë të kërkuesit dhe mbrojtësit të tij. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se këto pretendime të kërkuesit nuk janë ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për sa kohë që këto pretendime nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe nuk është mbajtur prej tyre një qëndrim përfundimtar në lidhje me to, ato nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson se ato janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

16. Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe atij të gjësë së gjykuar, pasi nuk janë marrë parasysh qëndrimet e mbajtura nga Gjykata që ka shqyrtuar çështjen në ngarkim të dy të pandehurve të tjerë. Sipas tij, pas ndarjes së procedimit për kërkuesin nuk ka pasur ndonjë veprim hetimor të mëvonshëm ku të jetë siguruar ndonjë provë e re, tjetër nga ato që janë mbledhur nga prokuroria gjatë fazës hetimore, përpara se çështja të dërgohej për gjykim për të tre të pandehurit. Në procesin gjyqësor penal në ngarkim të kërkuesit është vlerësuar se në bashkëpunim me shtetasit S.H. dhe SH.S. ai ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, ndërkohë që për këta të fundit gjykatat kanë konkluduar se këto vepra nuk janë kryer prej tyre dhe as në bashkëpunim me kërkuesin. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, që ka dhënë vendimin nr. 51, datë 6.6.2013, nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka administruar asnjë provë tjetër përveç sa kanë shqyrtuar gjykatat gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të dy të pandehurve të tjerë, për të cilët është vendosur pafajësia. Gjykatat që kanë gjykuar çështjen në ngarkim të kërkuesit nuk kanë marrë parasysh vendimin e formës së prerë nr. 33 datë 31.5.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, që ka vendosur pushimin e gjykimit për dy të pandehurit e tjerë, pasi ka arritur në përfundimin se janë të pafajshëm, duke nënkuptuar se nuk i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzoheshin as në bashkëpunim me kërkuesin. Në këtë mënyrë është shkelur edhe parimi i mbledhjes së provave në mënyrë të ligjshme, pasi në një vendim me të njëjtin objekt, shumë nga provat kanë rezultuar të papërdorshme.

17. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj, dhe ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi *(shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuesit duhet të shqyrtohen në këndvështrim të respektimit të standardit të sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet Gjykatës *(shih vendimin nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një

çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2007, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete *(shih vendimin nr. 7, datë 27.4.2005, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Bazuar në dispozitat procedurale, në gjykim provat merren me kërkesën e palëve dhe prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe Gjykata i vlerëson ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal, pasi sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues e bën procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese *(shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se pas përfundimit të hetimeve paraprake prokuroria ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të shtetasve SH.S. dhe S.H., si dhe kërkuesit Dritan (Gramoz) Rexhepi për kryerjen e disa veprave penale. Në kushtet kur ky i fundit ka qenë në mungesë, Gjykata ka bërë ndarjen e procedimit penal dhe gjykimi i tyre ka vijuar veçmas.

21. Në lidhje me çështjen penale në ngarkim të kërkuesit, referuar vendimit nr. 51, datë 6.6.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, rezulton se për deklarimin e fajësisë së kërkuesit, Gjykata është bazuar, mes të tjerash, edhe në këto prova: procesverbal i paraqitjes për njohje i datës 29.1.2006 i bashkëpandehurit SH.S. për kërkuesin; procesverbal i paraqitjes për njohje i datës 1.11.2006 i bashkëpandehurit SH.S. për shtetasin S.H.; procesverbal për deklarime nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime i datës 26.1.2006, i dhënë nga i bashkëpandehuri SH.S.; procesverbal për pyetjen e të pandehurit SH.S. i datës 26.1.2006; dëshmitë e dhëna në seancë gjyqësore nga shtetasit D.K., H.K., I.K., S.L. etj. Sipas vendimit të kësaj Gjykate *"si provë bazë në konkludimin e fajësisë së të pandehurit Dritan (Gramoz) Rexhepaj, Gjykata vlerëson deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri SH.S., gjatë hetimeve paraprake, me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, të 26.1.2006, në prani të mbrojtësit të tij, si dhe deklarimet e bëra nga ky i bashkëpandehur, me cilësinë e të pandehurit, në prani të mbrojtësit të tij, në datën 21.7.2006, deklarime ... në të cilat ky i bashkëpandehur ka sqaruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, si dhe të gjitha veprimet që ka kryer i pandehuri i këtij gjykimi, veprime të cilat kanë shkaktuar vrasjen e shtetasit D.K. dhe plagosjen e rëndë, me pasojë vdekjen të shtetasit R.B." (shih paragrafin 147 të vendimit)*.

22. Gjykata vëren, gjithashtu, se për sa u takon të pandehurve SH.S. dhe S.H. rezulton se përfundimisht, me vendimin e formës së prerë nr. 33 datë 31.5.2011, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, është vendosur pushimi i gjykimit, pasi nuk është vërtetuar fajësia e tyre. Sipas këtij vendimi: *"Përpos konstatimeve të sipërcituara që kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të "kontributit" "deklarime të të pandehurit SH.S." gjatë hetimeve paraprake me përmbajtje "vetakuzuese" dhe "akuzuese ndaj të tjerëve" në funksion të verifikimit të akuzës së kontestuar të të pandehurve SH.S.-S.H., Gjykata e Apelit për Krime të Rënda vlerëson se edhe dokumentimi i këtij kontributi prej policisë gjyqësore rezulton në kundërshtim me parashikimet ligjore... Deklarimet e shtetasit SH.S. në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/c-25, 79/c-25, 76-25 dhe 278/2 të KP-së, të datuara 26.1.2006, pra një ditë pas regjistrimit të emrit të tij në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të KPP-së, dhe deklarimet e tij të datuara 19.7.2006 dhe 21.7.2006, këtë radhë në cilësinë e të pandehurit për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/c-25, 79/c-25, 76-25 dhe 278/2 të KP-së, gjatë fazës së hetimeve paraprake, janë marrë prej oficerit të policisë gjyqësore në kundërshtim flagrant me përcaktimet e KPP-së." (shih faqen 25 të vendimit)*. Më tej, sipas gjykatës: *"Në të njëjtat kushte, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, rezultojnë edhe "deklarimet" (përmbajtja e tyre) e shtetasit SH.S., gjatë hetimeve paraprake, të datuara 19.7.2006 dhe 21.7.2006, këtë radhë në përfundim të tyre (hetimeve) të marra dhe të dokumentuara nga oficerët e policisë gjyqësore mbi "delegimin" e prokurorit, të përdorura në funksion të vendimmarrjes së Gjykatës me procedurën e kundërshtimit të*

deklarimeve të të pandehurit S. në seancë gjyqësore... Shmangia e policisë gjyqësore nga ky moment procedural (pyetja e të pandehurit të arrestuar) përfaqëson një element të rëndësishëm garantues në drejtim të realizimit edhe në fazën e hetimeve paraprake të një procedimi të drejtë, të gjithanshëm, të pakushtëzuar... Përfundimisht, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda konsideron se deklarimet akuzuese të të bashkëpandehurit SH.S. ndaj të pandehurit S.H., mbeten të pakonfirmuara prej "provave" të tjera të paraqitura nga prokurori pranë Gjykatës për Krime të Rënda në funksion të akuzave të kontestuara këtij të pandehuri..." (shih faqet 27 dhe 31 të vendimit)".

23. Bazuar në sa më sipër rezulton se në procesin gjyqësor të sipërcituar deklarimet e shtetasit SH.S., në të cilat janë bazuar gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit për deklarimin e fajësisë së tij, janë deklaruar të pavlefshme, pasi janë marrë në kundërshtim me përcaktimet e KPP-së. Në bazë të pikës 5, të nenit 193 të KPP-së, vendimet e formës së prerë mund të merren për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, duke u vlerësuar në unitet me provat e tjera. Në rastin konkret gjykatat edhe pse i referohen këtij vendimi, nuk marrin parasysh përfundimet e arritura prej tij në lidhje me provat kryesore të procesit të zhvilluar ndaj kërkuesit. Deklarimet e shtetasit SH.S., siç rezulton nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara, janë prova bazë ku mbështetet Gjykata për arritjen në një përfundim në lidhje me mekanizmin e ngjarjes dhe autorësinë e saj. Po ashtu, rezulton se Gjykata u referohet edhe dëshmive të dhëna nga disa shtetas të tjerë, të cilët referojnë për fakte të mësuara nga persona të tjerë, që kanë ndërruar jetë, të cilat janë përdorur në gjykim në bazë të nenit 154/2 të KPP-së. Gjykata vëren se megjithëse këto pretendime janë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë nga mbrojtësi i kërkuesit, Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e tij.

24. Gjykata thekson se barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme *(shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*. Po ashtu, referuar jurisprudencës se saj, Gjykata rithekson se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) *(shih vendimin nr. 65, datë 16.10.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Në këndvështrim të së drejtës së aksesit, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore, që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kërkuesit i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës. Në vlerësimin e kësaj Gjykate, kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 65, datë 16.10.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Për sa më sipër, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, që lidhen me mosrespektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave *(shih vendimin nr. 17, datë*

24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për shkak të mosdhënies së një përgjigjeje përfundimtare ndaj pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, ka cenuar edhe të drejtën e kërkuesit për të pasur një vendim të arsyetuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë

28. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka shkelur parimin e paanshmërisë në gjykim, pasi të njëjtët gjyqtarë të Kolegjit Penal kanë marrë pjesë në trupën gjykuese që ka shqyrtuar më parë rekurset kundër vendimeve penale të dhëna për kërkuesin.

29. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet *(shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e Gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm *(shih vendimin nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshëm në këndvështrimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt në lidhje me të njëjtin subjekt *(shih vendimin nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Duke vlerësuar respektimin e standardeve të mësipërme në çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se rekurset e paraqitura nga prokuroria dhe mbrojtësi i kërkuesit kundër vendimit nr. 69, datë 7.10.2013, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda janë shqyrtuar në Kolegjin Penal nga një trup gjykues i përbërë nga gjyqtarët E.I., T.N., G.Z., SH.S. dhe A.Z. (vendimi nr. 653, datë 2.4.2015 i Gjykatës së Lartë). Këta gjyqtarë kanë marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit penal nr. 59, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda (vendimi nr. 578, datë 22.6.2017). Në të dyja këto raste Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura. Po ashtu, rezulton se në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga prokurori kundër vendimit nr. 33, datë 31.5.2011, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, i cili u ka dhënë pafajësinë shtetasve S.H. dhe SH.S., kanë marrë pjesë të njëjtët gjyqtarë të Kolegjit Penal (vendimi nr. 1543, datë 6.12.2012 i Gjykatës së Lartë).

33. Bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin në Gjykatën e Lartë, rezulton se neni 432 i KPP-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse sipas nenit 433, rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji. Sipas nenit 434 të KPP-së, Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura. Në rastin konkret rezulton se Kolegji Penal që ka shqyrtuar rekurset në lidhje me çështjen e kërkuesit rezulton se është vënë në lëvizje fillimisht nga prokurori, pasi ankimi i mbrojtësit nuk është pranuar si i palegjitimuar, dhe më pas edhe nga kërkuesi. Duke qenë se shkaqet e ngritura në rekurs, brenda të cilave Gjykata e Lartë shqyrton

çështjen, kanë qenë të ndryshme, gjyqtarët e Kolegjit Penal që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit kundër vendimit nr. 59, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, nuk kanë marrë në shqyrtim dhe nuk janë shprehur mbi të njëjtat çështje të marra më parë në shqyrtim prej tyre, kur kanë vlerësuar shkaqet e rekursit të paraqitur nga prokurori kundër vendimit nr. 69, datë 7.10.2013, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim është i pabazuar.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin nga ana e Gjykatës së Lartë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, janë të bazuara dhe kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2017-578, datë 22.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtar kundër: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Shumica ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së shtetasit Gramoz (Dritan) Rexhepi dhe ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vendimin nr. 00-2017-578, datë 22.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe atij të gjësë së gjykuar, pasi nuk janë marrë parasysh qëndrimet e mbajtura nga Gjykata që ka shqyrtuar çështjen në ngarkim të dy të pandehurve të tjerë. Sipas tij, pas ndarjes së procedimit për kërkuesin nuk ka pasur ndonjë veprim hetimor të mëvonshëm, ku të jetë siguruar ndonjë provë e re nga ato që janë mbledhur nga prokuroria, gjatë fazës hetimore, përpara se ta çonte çështjen për gjykim për të tre këta të pandehur. Kërkuesi është gjykuar për faktin se në bashkëpunim me shtetasit S.H. dhe SH.S. ka kryer veprat penale të vrasjes, ndërkohë që për këta të fundit gjykatat kanë konkluduar se këto vepra nuk janë kryer prej tyre dhe as në bashkëpunim me kërkuesin.

3. Shumica, duke e trajtuar këtë, pretendimi në këndvështrim të respektimit të standardit të sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, ka vlerësuar se në procesin e zhvilluar ndaj kërkuesit, gjykatat, edhe pse i referohen vendimit të formës së prerë ndaj dy të pandehurve të tjerë (vendimi nr. 33, datë 31.5.2011 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, ku është vendosur pushimi i gjykimit, pasi nuk u vërtetua fajësia e tyre), nuk marrin parasysh përfundimet e arritura prej tij (deklarimin si të pavlefshme) në lidhje me provat kryesore të procesit, në të cilat gjykatat janë mbështetur në lidhje me mekanizmin e ngjarjes dhe autorësinë e saj *(shih paragrafin nr. 23 të vendimit të shumicës)*.

4. Për sa më sipër, shumica ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje pretendimeve të kërkuesit të ngritura në rekurs. Në këtë mënyrë, sipas shumicës, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si dhe të drejtën e

kërkuesit për të pasur një vendim të arsyetuar *(shih paragrafët nr. 26–27 të vendimit të shumicës).*

Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të shumicës, në vijim do të paraqes argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

5. Në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 433 të KPP-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar Gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në Gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata *(shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

6. Sipas jurisprudencës kushtetuese, në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe për këtë arsye shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin *(shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese).* Vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 18, datë 6.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

7. Nga ana tjetër, gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj *(shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

8. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vlerësimi dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe i marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën dhe mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre *(shih vendimin nr. 21, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

9. Bazuar në sa më sipër, vërej se në rastin konkret, çështja ka kaluar dy herë të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm dhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me qëndrimin e Gjykatës në procesin para ndarjes së procedimit ndaj tij dhe ndikimin e asaj vendimmarrjeje penale ndaj kërkuesit, janë vlerësuar dhe kanë marrë përgjigje. Gjykatat e zakonshme kanë çmuar provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së tyre të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Konkretisht, në vendimet gjyqësore që lidhen me çështjen e kërkuesit, gjykatat, pasi kanë analizuar dhe vlerësuar faktin se të pandehurve të tjerë u është dhënë pafajësia, janë ndalur në analizën dhe vlerësimin e provave në lidhje me përgjegjësinë

penale të kërkuesit, duke arritur në konkluzionin se ai është fajtor.

10. Si përfundim, si gjyqtare në pakicë, mendoj se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me çmuarjen dhe vlerësimin e provave, si atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, i cili nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Për pasojë, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga Gramoz (Dritan) Rexhepi duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 21, datë 15.3.2018

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN "MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 dhe nenit 43, shkronjat "a" dhe "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.5.2012, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

"Përmbajtja e anekseve 1 dhe 2, pjesë përbërëse e rregullores sipas nenit 20 të saj, ndryshon sipas përmbajtjes së anekseve 1 dhe 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi".

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Statistikave Financiare.

3. Ngarkohet kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genti Sejko

NR. I FORMA F1

EMRI I FIOK: Pasqyra e llogaritjes së rezervës së detyruar në LEKE, USD dhe EURO

PERIUDHA: Muaji

MONEDHA: Monedhë origjinale

NJESIA: Njësi monetare

Kodi	KATEGORITË E PASIVEVE	LEKË				Rezerva e detyruar në LEKË	USD				Norma e rezervës së detyruar	Rezerva e detyruar në USD	EURO				Norma e rezervës së detyruar	Rezerva e detyruar në EURO
		Rezident	Jorezident	TOTALI	Norma e rezervës së detyruar		Rezident	Jorezident	TOTALI				Rezident	Jorezident	TOTALI			
1	1	Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare																
111	1	Llogaria rrjedhëse me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare rezidente		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0
1112	1	Llogari rrjedhëse me institucionet e kreditit dhe mentjesore të tjera financiare rezidente					0.00					0						0
112	1	Llogari rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
1121	1	Llogari rrjedhëse në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente					0.00					0						0
16		Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare					0.00					0						0
161		Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare, rezidente *		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
1611		Depozita me afat		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
16112		Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
1612		Depozita me afat		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
16122		Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [1]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet [2]					0.00					0						0
162		Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet të tjera financiare jorezidente*		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
1621		Për afat					0.00					0						0
1622		Me afat		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [1]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet [2]					0.00					0						0
27		Detyrime nëtj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat					0.00					0						0
271		Llogari rrjedhëse		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
2711		Individë					0.00					0						0
272		Njësi tregtare dhe industriale private					0.00					0						0
273		Njësi tregtare dhe ndërmarrje publike					0.00					0						0
2734		Punonjës të bankës					0.00					0						0
2735		Klientë të tjerë					0.00					0						0
275		Depozita me afat		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0.00
2751		Individë		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [3]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [4]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet [5]					0.00					0						0
2753		Njësi tregtare dhe industriale publike		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [6]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [7]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet [8]					0.00					0						0
2754		Punonjës të bankës		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [9]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [10]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet [11]					0.00					0						0
2755		Klientë të tjerë		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [3]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [4]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet [5]					0.00					0						0
274		Certifikatat e depozitave		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
2741		Certifikatat e depozitave rezidente		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
27411		Individë		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [3]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [6]					0.00					0						0
		Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet [7]					0.00					0						0
27412		Njësi tregtare dhe industriale private		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	0.00	0.00	0.00	0	0
		Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [8]					0.00					0						0
		Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [9]					0.00					0						0

	Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet [10]					0.00					0					0
27413	Njësi tregtare dhe industriale publike	0.00	0.00	0.00		0.00	0	0	0		0	0	0	0		0
	Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [11]					0.00					0					0
	Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [12]					0.00					0					0
	Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet [13]					0.00					0					0
27414	Punonjës të bankës	0.00	0.00	0.00		0.00	0	0	0		0	0	0	0		0
	Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [5]					0.00					0					0
	Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [6]					0.00					0					0
	Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet [7]					0.00					0					0
27415	Klientë të tjerë	0.00	0.00	0.00		0.00	0	0	0		0	0	0	0		0
	Depozita me afat maturimi deri ne nje vit [5]					0.00					0					0
	Depozita me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet [6]					0.00					0					0
	Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet [7]					0.00					0					0
2742	*Certifikatat e depozitave të mbajtësit*	0.00	0.00	0.00		0.00	0	0	0		0	0	0	0		0
27421	Kryegjëja					0.00					0					0
34	**Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes**					0.00					0					0
342	*Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes*					0.00					0					0
	TOTALI	0.00	0.00	0.00		0.00	0	0	0		0	0	0	0		0

(Datë) (Punoi: Emri/Firma) (Emri/Firma e personit të autorizuar/Vula)

* Ketu do te pertshihen vetem llogaritë me institucionet e kreditit dhe financiare te tjera jorezidente (përjashtohen bankat)

1 Totali i kolonës T per Shoqëritë e Kursim Kreditit, Fondet e Investimit, Ndërmjetës të tjerë financiarë, Shoqëritë e sigurimit dhe Fondet e pensionit vullnetar, ne formularin F35 te Statistikave Monetare

2 Totali i kolonës V dhe X per Shoqëritë e Kursim Kreditit, Fondet e Investimit, Ndërmjetës te tjerë financiarë, Shoqëritë e sigurimit dhe Fondet e pensionit vullnetar, ne formularin F35 te Statistikave Monetare

3 Totali i kolonës E për Shoqëritë e Kursim Kreditit, Fondet e Investimit, Ndërmjetes të tjerë financiarë, Shoqëritë e sigurimit dhe Fondet e pensionit vullnetar, ne formularin F35.1 te Statistikave Monetare

4 Totali i kolonës F për Shoqëritë e Kursim Kreditit, Fondet e Investimit, Ndërmjetës te tjerë financiarë, Shoqëritë e sigurimit dhe Fondet e pensionit vullnetar, ne formularin F35.1 te Statistikave Monetare

5 Depozitat me afat maturimi deri ne 1 vit per zerat 2731+ 2734 +2737 te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones L, N, P dhe Q per sektoret "individe dhe NPISH", ne formularin F35 te Statistikave Monetare

6 Depozitat me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet per zerat 2731+ 2734 +2737 te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones T per sektoret "individe dhe NPISH", ne formularin F35 te Statistikave Monetare

7 Depozitat me afat maturimi mbi 2 vjet per zerat 2731 + 2734 +2737 te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones V dheX per sektoret "individe dhe NPISH", ne formularin F35 te Statistikave Monetare

8 Depozitat me afat maturimi deri ne 1 vit per zerat 2732 (korporatat jofinanciare private) te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones L, N, P dhe Q per sektoret "korporata jofinanciare private", ne formularin F35 te Statistikave Monetare

9 Depozitat me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet per zerat 2732 (korporatat jofinanciare private) te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones T per sektoret "korporata jofinanciare private", ne formularin F35 te Statistikave Monetare

10 Depozitat me afat maturimi mbi 2 vjet per zerat 2732 (korporatat jofinanciare private) te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones V dheX per sektoret "korporata jofinanciare private" ne formularin F35 te Statistikave Monetare

11 Depozitat me afat maturimi deri ne 1 vit per zerat 2733 (korporata jofinanciare publike) te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones L, N, P dhe Q per sektoret "korporata jofinanciare publike" ne formularin F35 te Statistikave Monetare

12 Depozitat me afat maturimi mbi 1 vit deri ne 2 vjet per zerat 2733 (korporatat jofinanciare publike) te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones T per sektoret "korporata jofinanciare publike", ne formularin F35 te Statistikave Monetare

13 Depozitat me afat maturimi mbi 2 vjet per zerat 2733 (korporatat jofinanciare publike) te depozitave me afat dhe certifikave te depozitave do te jene te barabarte me totalin e kolones V dheX per sektoret "korporata jofinanciare publike", ne formularin F35 te Statistikave Monetare



VENDIM
Nr. 17, datë 2.3.2018

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME LIBOHOVË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/"a", të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Libohovë, me:

Drejtues ligjor: Aldi Sinani;

Drejtues teknik: Kristaq Jorgaqi.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Libohovë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të kësaj shoqërie është Njësitë Administrative Libohovë (Bashkia Libohovë).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare). Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Libohovë duhet të aplikojë për zgjerim të zonës së shërbimit për njësitë administrative Qendër, Libohovë dhe Zagorie, menjëherë pas reflektimit të tyre në QKB.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatime Imeraj

VENDIM
Nr. 18, datë 22.3.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E METODOLOGJISË PËR VENDOSJEN E TARIFAVE

Në mbështetje të nenit 14, pika 1, germat "e" dhe "i" dhe të nenit 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin mbi nevojën për ndryshimin e "Metodologjisë për vendosjen e tarifave", përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

1. Prania e katër dokumenteve, përmbajtja e të cilave përsëritet, në vend që ta lehtësojë praktikën që ndiqet e bën më të ndërlikuar atë.

2. Mungesa e përgatitjes dhe e paraqitjes së planeve të biznesit 5-vjeçar vështirëson parashikimin për ecurinë e shoqërive, investimet e nevojshme që duhet të kryejnë ato dhe prioritetet përkatëse për përmirësimin e shërbimit, të cilat ndikojnë në tarifat e shërbimit.

3. Dokumentacioni aktual që duhet paraqitur së bashku me aplikimin për ndryshim tarife ka nevojë për përmirësime e plotësime.

4. Mosparaqitja e aplikimit për ndryshimin e tarifave me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe plotësimi i tij më vonë, duke e tejzgjatur procedurën dhe vendimmarrjen, shtron nevojën që të hiqet afati, data 30 qershor i vitit aktual dhe aplikimi të jetë i lirë për t'u bërë në çdo moment të vitit, me kushtin që dokumentacioni ligjor, teknik dhe ekonomik të jetë i plotë.

5. Duke u nisur nga fakti që pjesa më e madhe e shoqërive janë shumë të dobëta financiarisht, mbulojnë kostot O&M në nivele të ulëta, por nga ana tjetër ka shoqëri që kanë një performancë menaxheriale dhe operative shumë të mirë, të cilat aplikojnë për ndryshimin e tarifave me qëllim akumulimin e të ardhurave për shlyerjen e kredive dhe më tej për të bërë investime në vlera të konsiderueshme, lind nevoja për rishikimin e metodologjisë duke i kategorizuar shoqëritë sipas mbulimit të kostove.

6. Rishikimi i treguesve kryesorë të performancës, të cilët duhet të jenë të matshëm, me qëllim analizën e tyre dhe impaktin që ato do të japin në përcaktimin e tarifës.

7. Nevoja për rishikimin e skemës së procesit të aplikimit, ndryshimi dhe thjeshtimi i saj.

8. Nevoja për përmirësimin dhe unifikimin e terminologjisë të termave të përdorur.

9. Nevoja për rishikimin e nenit mbi pagesën rregullatore.

10. Nevoja për rishikimin e monitorimit të zbatimit të tarifave, metodologjia duhet të përcaktojë në detaje si do të kryhet monitorimi, cilët tregues do të monitorohen sipas prioritetit dhe sanksionet apo penalitetet në rast mosarritjeje.

11. Zbatimi i reformës territoriale që presupozoi edhe riorganizimin e shoqërive UK, bën të domosdoshme ndryshime dhe përshtatje të dokumentacionit shoqërues të aplikimit, kjo kryesisht në dokumentet teknike dhe ekonomike:

- Informacionin teknik dhe ekonomik në tërësi për shoqërinë e riorganizuar;
- Aplikimi i tarifave të diferencuara për zonën ekzistuese dhe ato të reja ka bërë të mundur përpilimin e tabelave ndihmëse për të marrë këtë informacion, gjë e cila duhet të pasqyrohet në metodologjinë e rishikuar.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për ndryshimin e vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura"; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatime Imeraj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 64-2017-1977 (5), datë 21.12.2017, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetases Zafire Kola, e datëlindjes 26.5.1985, si dhe caktimin si kujdestare dhe përfaqësuese ligjore të saj, shtetasen Labika Kola.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 896, datë 5.2.2018, vendosi deklarimin të vdekur të shtetasve: Bajram Allamani, i datëlindjes 24.5.1961; si dhe të vajzës së tij, shtetases Esmeralda Allamani, e datëlindjes 8.1.1987; gjithashtu edhe caktimin e kërkuesit Përparim Allamani si kujdestar ligjor për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të tyre.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë